VENDIM
Nr. 672, datë 2.9.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 54, DATË 5.2.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURËS E TË MËNYRËS SË DHËNIES ME QIRA, ENFITEOZË APO KONTRATA TË TJERA TË PASURISË SHTETËRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve", të miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, dhe të neneve 784 e 801, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në kreun III "Tarifa dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë" bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja "a", e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Për ndërtesat, të cilat quhen të tilla sipas përcaktimeve në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në fushën e planifikimit të territorit, tarifa dysheme e qirasë mujore për metër katror është 0.3% e vlerës mesatare të shitblerjes së banesave, e përcaktuar në udhëzimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, në fuqi në momentin e dhënies me qira apo enfiteozë të pasurise shtetërore. Shembujt e zbatimit do të parashikohen në udhëzimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, i cili do të miratohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.".

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Kur jepet me qira ose enfiteozë trualli i lirë, tarifa dysheme e qirasë mujore është sipas aneksit C, bashkëlidhur këtij vendimi.".

c) Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9. Për tunelet dhe vendstrehimet që jepen me qira, tarifa dysheme e qirasë mujore, e përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij kreu, pjesëtohet me 5.".

2. Tabela A "Tarifat dysheme të qirasë mujore për ndërtesat sipas qarqeve", shfuqizohet.

3. Dispozitat e këtij vendimi zbatohen për procedurat e shpallura pas hyrjes së tij në fuqi.

II. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ANEKSI C
TARIFAT DYSHEME TË QIRASË MUJORE PËR TRUALL TË LIRË SIPAS QARQEVE

QARKU	SPECIFIKIMI TERRITORIAL	TARIFA DYSHEME
	Bashkia Tiranë	121

Tiranë	Qarku Tiranë	97
Berat	Bashkia Berat	13
	Qarku Berat	10
Dibër	Bashkia Dibër	10
	Qarku Dibër	8
Durrës	Bashkia Durrës	42
	Qarku Durrës	33
Elbasan	Bashkia Elbasan	40
	Qarku Elbasan	32
Fier	Bashkia Fierit	37
	Qarku Fier	29
Gjirokastër	Bashkia Gjirokastër	15
	Qarku Gjirokastër	12
Korçë	Bashkia Korçë	25
	Qarku Korçë	20
Kukës	Bashkia Kukës	16
	Qarku Kukës	13
Lezhë	Bashkia Lezhë	26
	Qarku Lezhë	20
Shkodër	Bashkia Shkodër	28
	Qarku Shkodr	23
Vlorë	Bashkia Vlorë	29
	Qarku Vlorë	23